



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim Simultan

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof.Asoc.Dr. Alma Pinari
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 15 leksione / 25 seminare
Viti akademik: 2024-2025, Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: alma.pinari@unitir.edu.al
almapinari@gmail.com

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit synohet: Formimi i shprehive të perceptimit të ligjërimit të oratorit njëherazi me gjetjen e zgjidhjeve përkthimore dhe transmetimin e informacionit në kushtet e limitit ekstremal të kohës; zhvillimi i aftësive të interpretimit simultan të teksteve me tematikë dhe shkallë të ndryshme vështirësie nga gjuha ruse në shqipe dhe anasjelltas; zhvillimi i aftësive për të ekzekutuar siç duhet, në përputhje me tekstin dhe standardet e përdorimit, dhe tipologjinë e teksteve në gjuhën e caktuar, transmetimin me gojë të një mesazhi nga gjuha e huaj në gjuhën amtare, dhe anasjelltas; thellimi dhe zgjerimi i fondit të njohurive kulturore të studentëve;

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ushtrojë kompetencën e analizës përkthimore, për të përcaktuar qëllimin e transmetimit, karakterin e tij receptor dhe llojin e tekstit të përkthyer;
2. Të zgjedhë strategjinë e përgjithshme në përkthim, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe llojin e tekstit origjinal;
3. Të kryejë një përkthim me gojë të teksteve brenda programit të përcaktuar në subjekte me shkallë të ndryshme të vështirësie, duke përdorur metodat dhe teknikat themelore të përvetësuar, semantike, stilistike etj.;
4. Të përdorë fjalorë profesionalë, databaza dhe burime të tjera të informacionit shtesë;

Rezultatet e pritshme:

1. Zhvillimi i aftësive të interpretimit simultan – Studenti do të jetë në gjendje të perceptojë dhe të përkthejë në kohë reale mesazhe nga gjuha ruse në shqip dhe anasjelltas, në kushte me presion kohe dhe me saktësi komunikative.
2. Zbatimi i strategjive përkthimore dhe mjeteve teknologjike – Studenti do të aplikojë strategji të përshtatshme për përkthimin simultan, duke përdorur fjalorë profesionalë, databaza, regjistruar zëri dhe pajisje kompjuterike për të përmirësuar cilësinë e interpretimit.
3. Përshtatja e përkthimit me kontekstin kulturor dhe tematik – Studenti do të demonstrojë aftësi për të interpretuar tekste me vështirësi të ndryshme dhe për t'i përshtatur ato sipas standardeve gjuhësore dhe njohurive kulturore të nevojshme për një komunikim efektiv.